



A.nr.598/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malësore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.598/2026 të datës 04.06.2026, të parashtruar nga ankuesi N.Sh, me përfaqësues të autorizuar avokat Muharrem Kurtaj, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.07.2026, mori këtë

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.598/2026 e datës 04.06.2026,e parashtruar nga ankuesi N.Sh.

A r s y e t i m

Ankuesi N.Sh,(në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 04.06.2026, përmes përfaqësues të autorizuar avokatit Muharrem Kurtaj, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar nën shenjë A.nr.598/2026, kundër vendimit të Komisionit të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 10.06.2026, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 15.06.2026, ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2568/2026, e datës 04.06.2026,e parashtruar nga ankuesi drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;

Vendimin me numër protokolli 14 KA/2, të datës 15.05.2026, të Komisionit të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ankesë e datës 22.04.2026, drejtuar Komisionit për Ankesa; Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025; Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2024; Kontrata e punës e datës 03.07.2018, për ankuesin; Vendim me numër protokolli 27.10.2022; Raport testimi; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.06.2026, dërguar nga S.A, për A.B; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 598/2026, e datës 15.06.2026; Emali i datës 10.06.2025; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 27.02.2026; Vendimi me numër protokolli Kd. Nr. 06/26, i datës 26.03.2026, i Komisionit Disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.598/2026, të datës 04.06.2026, të parashtruar nga ankuesi, N.Sh, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Kontratës së Punës, të datës 03.07.2018, është i punësuar në pozitën ‘*Zyrtar Korrektues*’, në Shërbimin Korrektues të Kosovës në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Me tej Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes Vendimit me numër KD.nr.06/2026 të datës 26.03.2026 ankuesit i shqipton masën disiplinore “*Largim nga Shërbimi civil*”. Ndërsa me datën 22.04.2026, ankuesi kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës me ankesë i drejtohet Komisionit të Ankesave, ndërsa Komisioni i Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes vendimit me numër protokolli 14Ka/2, të datës 15.05.2026, ankuesit i refuzon ankesën si të pa bazuar duke e lenë në fuqi, vendimin me numër protokolli KD.nr.06/2026 të datës 26.03.2026, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ankuesi N.Sh i pakënaqur me vendimin me numër protokolli 14KA/2, të datës 15.05.2026 të Komisionit të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 04.06.2026 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore kundër vendimit 14KA/2, të datës 15.05.2026 të Komisionit të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes të cilin vendim ka lenë në fuqi vendimin me numër protokolli KD.nr.06/2026 të datës 26.03.2026, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, lidhur me shqiptimin e Masës Disiplinore “*Largim nga Shërbimi Civil*”.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit për shqyrtim dhe vendosje lidhur me këtë çështje administrative mori për bazë dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me nëpunësit me status të veçantë, gjegjësisht nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, ku përcaktohet: “1. *Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues*, si dhe dispozitat e nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 2.18, nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1, të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku thuhet se: 1. *Në paragrafin 2. të nenit 3 të ligjit bazik pas nën-paragrafit 2.9. shtohen nën-paragrafët si në vijim: 2.18. zyrtarët korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës. 1. Nëpunësi civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunësit civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarit e Shërbimit Korrektues të Kosovës, përjashtimisht zyrtarët korrektues.*

Andaj nisur nga fakti se ankuesi sipas Kontratës së Punës, të datës 03.07.2018, është i punësuar në pozitën “Zyrtar Korrektues”, në Shërbimin Korrektues të Kosovës në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan. Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, andaj, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se; *Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil*, rrjedhë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.598/2026 të datës 04.06.2026 të parashtruar nga ankuesi.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.598/2026

Rushit Kajtazi

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesi avokatit Muharrem Kurtaj;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.